



Këshilli i Qarkut Vlorë

Buletin 2018

Tiranë, 2018

Titulli: Buletin 2018

Përgatit: Këshilli i Qarkut Vlorë

Redaktoi: Nevila Zeneli

Shtypur në “JUPITER GROUP”

Përgatit për shtyp: Nevila Zeneli

Përmbajtja:

- Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Këshillit të Qarkut.....5
- Misioni, objektivat e Këshillit të Qarkut Vlorë, për vitin 2018.....4
- Takimet gjatë vitit 2018:
 - a. Takimet e realizuara nga Qarku Vlorë.....6
 - b. Pjesëmarrja në takimet në nivel kombëtar10
 - c. Pjesëmarrja në takimet në nivel ndërkombëtar.....14
- Këshilli: Mbledhjet dhe vendimet e vitit 201819
- Investimet gjatë vitit 201824
- Programi i zhvillimit28
 - a. Projektet e BE-së28
 - b. Projekti i qendrës psiko-sociale “Vatra”37
 - c. Zhvillimi i partneriteteve39
- Shërbimet e drejtpërdrejta ndaj qytetarit44
 - a. Titujt e Nderit44
 - b. Linjat ndërqytetëse45
 - c. Shërbimet sipas VKM 608, datë 05.09.2012 dhe VKM 329, datë 16.05.201247
 - d. Njësia për të drejtat e fëmijëve;
 - e. Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (DAMT)....48
 - f. Shërbimi ndaj qytetarëve49
 - g. Bajkaj Land 51
- Raport analitik i buxhetit të vitit 201854

Misioni i Këshillit të Qarkut Vlorë

Në funksion të ndërtimit e zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal, harmonizimit të tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër të dhënë me ligj, Këshilli i Qarkut Vlorë ka në misionin e vet, bashkëpunimin dhe koordinimin midis njësive të qeverisjes vendore dhe këtyre me qeverinë qendrore, për një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të territorit.

Objektivat e Këshillit të Qarkut Vlorë, për vitin 2018

- Pjesëmarrja e Këshillit të Qarkut Vlorë, në projekte, studime dhe investime konkrete, për hartimin e politikave të zhvillimit të rajonit dhe harmonizimin e tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku.
- Krijimi i bashkëpunimit ndërbashkiak dhe ndërrajonal.

- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara publikut e sigurimi i një qeverisjeje më të mirë.
- Përmirësimi i rolit të qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e integritimit evropian.

Për të realizuar misionin dhe objektivat, Këshilli i Qarkut Vlorë:

- Ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë komuniteteve, ofron mundësi që reflektojnë, çfarë është më e mira për këtë gjeneratë dhe për gjeneratat e ardhshme.
- Ofron bashkëpunim me njësitë vendore, për bashkëfinancime në projekte gjithpërfshirëse, si ato për ndërtimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore, në të gjithë komponentët e saj dhe të shtrirë në të gjithë territorin nën administrim etj.
- Garanton vetëqeverisjen vendore, në përputhje me parimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore.
- Synon plotësimin sa më mirë të nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të zhvillimit të tyre.



Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Këshillit të Qarkut

Kam kënaqësinë, t'ju përcjell aktivitetin e Këshillit të Qarkut Vlorë, për këtë vit që po mbyllim, përmes buletinit të Qarkut Vlorë 2018.

Edhe pse koha e angazhimit tim, në drejtim të këtij institucioni, është më pak se dy vjet, përpjekjet për t'i dhënë kuptimin e plotë dhe të duhur veprimtarisë së institucionit, brenda kuadrit ligjor, mbi bazën e të cilit funksionon këshilli i qarkut, por edhe në koherencë me qasjen strategjike të zhvillimit territorial në një kontekst më të gjerë europian, besoj që po ofrojnë rezultatet e para pozitive.

Sigurisht që, këto arritje bazohen, jo vetëm në vizionin me një qasje të re, por edhe punën e përkushtuar të administratës, në bashkëpunimin me njësitë vendore, por edhe qendrore, si edhe me organizma të tjerë që operojnë në territor, përfshirë vetë qytetarët.

Këta të fundit kanë qenë vlerësuesit më objektivë në shërbimin e drejtpërdrejtë të ofruar, por edhe në bashkëpunimin konkret mes shkëmbimit të ideve e problematikave të ndryshme.

Bazuar në strategjinë e qarkut 2011-2020 për zhvillimin, prioriteti kryesor i Qarkut të Vlorës, është turizmi. Me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë mjedisore-kulturore, që do të shërbejnë si tërheqja kryesore për turistët-që presin standarde të cilësisë së lartë nga një vend që aspiron integrimin - është i nevojshëm një

model për zhvillimin e turizmit, për ta orientuar drejt qëndrueshmërisë mjedisore-sociale. Kjo nënkupton krijimin e një oferte turistike më të larmishme, duke futur bregun e zonat e thella në itineraret tematike, duke përfshirë atraksionet e ruajtura mirë, akomodimin e shërbimet e cilësisë së lartë. Koordinimi, bashkëveprimi i aktorëve rajonalë, lokalë dhe atyre në nivel qendror, me mbështetjen edhe të investitorëve strategjikë e donatorëve potencialë, përbëjnë çelësin e suksesit në krijimin e një modeli të dëshirueshëm, për t'u ndjekur në të ardhmen.

Kjo është realisht, sfida e punës sonë.

Le të kontribuojmë bashkërisht, për të arritur këtë qëllim të lartë, me bindjen që këto rezultate nuk janë thjesht të një viti specifik, por as edhe vetëm arritjet e një grupi njerëzish. Le të jenë rezultatet e të gjithëve, të atilla që do të ndiqen nga të tjera arritje dhe do t'i qëndrojnë çdo kohe!

Duke qenë edhe fundi i vitit 2018, gjej rastin t'ju përshëndes, duke ju uruar një vit të mbarë dhe me arritje domethënëse në jetën tuaj!

Ervis Moçka

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Takimet e realizuara gjatë vitit 2018

Aktivitetet e zhvilluara nga Qarku Vlorë

Në përmbushje të funksioneve dhe në bazë të prioriteteve të këtij viti, kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, ka vlerësuar organizimin e disa takimeve, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme si: Problematikat e menaxhimit të landfillit të Bajkaj Land, qasje strategjike të zhvillimit të territorit me mbështetjen e donatorëve, regjistrimi i pronave në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit dhe lehtësitë për grupin e Task Forcës, Komisioni i Mbrojtjes së tokës për evidentimin dhe rehabilitimin e tokës bujqësore.

Kështu, më datë 15 shkurt 2018, është organizuar një takim me përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, për të trajtuar problematikat mbi landfillin e “Bajkaj Land”. Të pranishëm në këtë takim, kanë qenë: Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, zv. ministrja e Mjedisit, znj. Ornela Çuçi, përfaqësues nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësues të nivelit politik dhe specialistë të bashkive të Qarkut Vlorë.



Në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë Gjermane për Zhvillim, GIZ, është organizuar një takim me drejtuesin e zyrës së koordinimit të GIZ në Shqipëri, z. Hans-Jürgen Cassens dhe stafin e tij, ku janë diskutuar gjetjet dhe rezultatet e programit 4-vjeçar, “Zhvillimi i Integruar i Qëndrueshëm i Rajonit

të Bregdetit Jugor” dhe programi i ri mbi “Zhvillimin e zonave rurale”, që pritet të zbatohen për qarkun Vlorë. Në këtë takim, ekspertët e misionit gjerman, shpjeguan dy shtyllat kryesore mbi të cilat do të orientohet ky program: Turizmi rural dhe bujqësia. Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Prefekti i Qarkut Vlorë, u fokusuan në një përshkrim të potencialeve turistike të Qarkut, si dhe nisimat që kanë ndërmarrë shtatë bashkitë e Qarkut dhe vështirësitë që kanë hasur në lidhje me implementimin e strategjive në sektorin e turizmit.



Më datë 19/02/2018, Këshilli i Qarkut Vlorë organizoi një takim për problematikën e linjave të transportit urban. Pjesëmarrës në takim, ishin përfaqësues nga bashkitë e Qarkut Vlorë - drejtorë të Drejtorisë së Shërbimeve me specialitetet përkatës. Në takim u diskutuan oraret e stacioneve të qëndrimit dhe u arrit në një zgjidhje të dakordësuar nga çdo bashki.



Në kuadër të aktivitetit, “Ministri në Qarkun Vlorë”, Këshilli i Qarkut Vlorë organizoi një takim informues të projektit “REAGO PËR MBETJET” / “WASTE REACT”: Menaxhimi i integruar i mbetjeve për nxitjen e riciklimit dhe kompostimit në 7 rajonet ndërkufitare”. Në këtë takim, ishin të pranishëm: Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, z. Blendi Klosi, së bashku zv. ministren e Mjedisit, znj



Ornela Çuci, deputetët e qarkut të Vlorës, znj. Vilma Bello, z. Edi Leka, z. Fate Velaj, prefekti i Qarkut Vlorë, z. Flamur Mamaj, kryetari i bashkisë Vlorë, z. Dritan Leli, si dhe titullarë dhe përfaqësues nga institucione të tjera, lokale e rajonale: Agjencia e Zhvillimit Rajonal 4, “Bajkaj Land” sh.p.k, Inspektoriati Rajonal i Mjedisit, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, Drejtorja Arsimore Ra-

jonale Vlorë, Qendra Rinore Vlorë, etj. Kryetari i Këshillit të Qarkut theksoi ndjeshmërinë që ka qarku Vlorë, si territor ndaj menaxhimit të mbetjeve, jo vetëm se është një qark i fokusuar në zhvillimin e turizmit, por edhe se ka në menaxhim një landfill të rëndësishëm si ai në Bajkaj, çka ka kërkuar një përqendrim cilësor të punës së qarkut, në menaxhimin dhe përballjen me vështirësitë dhe sfidat, edhe në koordinim me njësitë e qeverisjes vendore.



Me qëllim koordinimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit për regjistrimin e pronave shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si dhe me ndjeshmërinë për të përmbushur sa më me eficiencë, këtë prioritet të vendosur nga qeveria qendrore, në mjediset e Këshillit të Qarkut Vlorë, u zhvillua një takim me përfaqësues të

ministrisë së Turizmit, Task Forcës dhe të institucioneve vendore.

Në fillim të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2018, u mbledh Komisioni i Mbrojtjes së Tokës, organizimi dhe funksionimi i të cilit parashikohet në ligjin nr. 9244 të vitit 2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”. Të pranishëm në mbledhje, ishin anëtarët e KMT-së, sipas VKQ, Prefekti i Qarkut Vlorë, Drejtori i Policisë së Qarkut Vlorë, kryetarët e bashkive Himarë, Delvinë, Finiq, Konispol, Drejtori i Bordit të Kullimit, Drejtori i Baseneve, Drejtoresha e QTTB-së, DAMT Qarkut Vlorë,



ZAMT Delvinë, ZAMT Sarandë, Shërbimi Pyjor Finiq, përfaqësues nga drejtoria e Bujqësisë Qarku Vlorë dhe Drejtori i ARM-së.

Është mbledhur Komisioni i Mbrojtjes së tokës, anëtarë të të cilat janë përfaqësues të lartë të qeverisjes vendore, të mbështetur nga specialistët e fushës, për të diskutuar çështje aktuale për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore në Qarkun e Vlorës.

Si çështje kryesore u diskutuan:

- 1- Rëndësia e 40% të taksës së tokës bujqësore që, si detyrim ligjor, duhet të vihet në dispozicion për rehabilitimin e tokave bujqësore.
- 2- Ngritja e një komisioni me specialistë të fushës, për të evidentuar devijimet e shtretërve të lumenjve.
- 3- Nevoja dhe mundësitë nga ana e Bordit të Kullimit, për pastrimin e kanaleve të para, të cilat janë në administrimin e tij, si funksion kryesor.
- 4- Bashkëpunim ndërinstitucional midis aktorëve lokalë dhe vendorë.

Gjithashtu, Kryetari ka pritur në zyrën e tij përfaqësues diplomatikë, investitorë dhe donatorë të ndryshëm, me qëllim ndërtimin e raporteve të mira institucionale dhe





paraqitjen e potencialeve të territorit, si dhe mundësitë reale për investim dhe promovim më të gjerë.

Pjesëmarrje në takimet në nivel rajonal dhe kombëtar

Çështje të identifikuara dhe të trajtuara në nivel rajonal, janë bërë pjesë e tryezave të përbashkëta, të zhvilluara në nivel qendror. Kështu, për çështjen e menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta në nivel kombëtar, Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë ka marrë pjesë në takimin, “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta në Shqipëri”, të zhvilluar në Gjirokastrë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, qarqeve dhe prefekturave të Gjirokastrës dhe Vlorës. Në takim u paraqit si praktikë pozitive venddepozitimi sanitar i menaxhuar nga “Bajkaj Land” - shoqëri ku Këshilli i Qarkut Vlorë, është aksioner i vetëm.

U diskutuan problematikat, sfidat, si dhe çfarë duhet përmirësuar për menaxhimin sa më të mirë të mbetjeve, për të patur një mjedis sa më të pastër.



Gjatë vitit 2018, Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë ka përfaqësuar institucionin e Këshillit të Qarkut Vlorë, si dhe Shoqatën e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, me funksionin e deleguar në mbledhjet e Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, organizuar nga AMV - Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë ka përfaqësuar institucionin e Këshillit të Qarkut Vlorë, si dhe Shoqatën e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, me funksionin e deleguar në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore dhe Qeverisjes Vendore, ku janë diskutuar dhe trajtuar çështje të rëndësishme të organizimit dhe rolit të njësive të qeverisjes vendore, si dhe raportit e bashkëpunimit me qeverisjen qendrore.



Këto kanë qenë tryeza diskutimesh, shkëmbime praktikash pozitive, si edhe paraqitje të sfidave dhe vështirësive, që institucionet ndeshin në përmbushje të funksioneve të tyre, si njësi të vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, janë diskutuar dhe janë dhënë sugjerimet për projektvendime të rëndësishme, si:

- 1) Projektvendimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- 2) Projektvendimi për ambalazhet dhe mbetjet e tyre;
- 3) Projektvendimi për integrimin europian.

Një prej pikave të rëndësishme që është diskutuar, ka qenë Strategjia Kom-bëtare Ndërsektoriale, për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore. Diskutimi është fokusuar në një analizë të reformës territoriale dhe në çështje akoma të hapura, si roli i qarqeve dhe lidhja e tyre me zhvillimin rural.

Gjithashtu, vlen të përmenden disa prej çështjeve, mbi të cilat është diskutuar gjatë këtyre takimeve:

- Modeli i programimit të transparencës dhe sistemi i matjes për qeverisjen vendore.
- Katër akte nënligjore mbi mbrojtjen sociale, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe mekanizmat e referimit të rastit në nivel vendor.
- Një projektligj mbi organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit, me fokus zhvillimin rural.
- Një projektligj për disa ndryshime dhe amendime të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me fokus përfshirjen e diasporës.
- Prezantim mbi menaxhimin e funksioneve të decentralizuara, lidhur me infrastrukturën e edukimit shkollor.
- VKM, “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorial, të VKM-së së njësisve të vetëqeverisjes vendore” dhe
- VKM, “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit midis administratorëve të ndërtesave të banimit, njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit”.



Në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe ndërrajonal, si pjesë e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë, si dhe të programit të Euro Rajonit Adriatiko-Jonian, Këshilli i Qarkut Vlorë ka marrë pjesë dhe është angazhuar në diskutime cilësore në tryezën e përbashkët, “Adriatiku, deti që bashkon veprimin për mbikëqyrjen dhe garantimin e sigurisë detare”, organizuar nga Këshilli i Qarkut Tiranë, në bashkëpunim me struktura të rëndësishme të programeve europiane, si Eurorajoni Adriatiko-Jonian dhe IPA Adriatik. Takimi është orientuar sipas dy drejtimeve kyçe: Strategjiko-politike, të përfaqësuar nga drejtues politikë qendrorë, rajonale dhe teknikë, të përfaqësuar nga profesorë të Universitetit, ekspertë të fushës së sigurisë detare dhe specialistë të mjedisit.



Cilësia e kësaj tryeze, u vlerësua edhe në aspektin e parashtrimit të problemeve aktuale, zgjidhja e të cilave lidhej nga bashkëpunimi i ngushtë dhe reciprok i autoriteteve lokale, por edhe qendrore të të dyja vendeve përballë Adriatikut, Italisë dhe Shqipërisë. Diskutimet e kësaj tryeze nxorën në pah edhe domosdoshmërinë e pranisë së Shqipërisë, në tryezat europiane politike dhe teknike, ku diskutohen dhe hartohen strategji dhe programe të përbashkëta për sigurinë detare.

Këshilli i Qarkut Vlorë ka marrë pjesë në takimet e ndryshme të organizuara nga njësitë vendore, të tilla si: Festa e Ullirit në Lukovë-Himarë dhe Festa e Mandarinës në Konispol. Këto aktivitete kanë qenë në kuadër të programit, “Zhvillimi i Integruar i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor”, që po zbatohet prej 4 vjetësh nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim, në komitetin drejtues të të cilit është edhe Kryetari i Qarkut dhe kanë për qëllim promovimin e potencia-

leve të territorit të Qarkut të Vlorës, përmes prodhimeve vendase, kulturës dhe traditës së pasur, si dhe inkurajimin e investimeve të reja, nën një slogan: “South inspires you!” – “Jugu të frymëzon!”.



10:00-11:00	Atelier Lukova: Presantimi i projekt-ideve në kornizën e PDV
11:00-11:20	Çelja e Festës së Ullirit
11:20-13:30	“Turi i ullirit” në plantacione; Konkursi i vjeljes së ullinjve;
13:30-14:00	Vizita në fabrikën e vajit të ullirit “Gjeneral” prodhimi i vajit nga ullinjët e mbledhur.
	Degustimi dhe miksimi i vajit të ullirit me produkte tradicionale dhe nën produkte të tjera



Aktivitetet ndërkombëtare


Si anëtar i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit të Programit Ndërkufitar, Greqi-Shqipëri 2014-2020, Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë ka marrë pjesë në takimin e IV-t të këtij komiteti, ku janë diskutuar çështje të menaxhimit të tri thirrjeve të para dhe shpallja e thirrjes së katërt, me dy prioritete:

1. Rritja e efciencës energjetike në institucionet dhe hapësirat publike;
2. Ruajtja dhe promovimi i burimeve natyrore dhe kulturore, me qëllim zhvillimin e turizmit ndërkufitar.



Si anëtar i Asamblesë së Rajoneve Europiane, Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë ka marrë pjesë në javën Europiane për Qytetet dhe Rajonet, zhvilluar në Bruksel në datat nga 8 deri 11 tetor 2018. Ky është një aktivitet i përvitshëm, që organizohet nga Komisioni European, në bashkëpunim me organizma të ndryshëm europianë, me qëllim diskutimin e tematikave të rëndësishme: E ardhmja e kohezionit; zhvillimi territorial; edukimi, kultura dhe rinia; çështje detare; mjedisi, klima dhe energjia; përfshirja sociale dhe migracioni; zhvillimi ekonomik dhe punësimi; bashkëpunimi ndërkombëtar dhe BE-ja, si aktor global; agrikultura dhe ushqimi, kërkimi dhe inovacioni, qeverisja dhe kapacitetet administrative, dixhitalizimi dhe TIK. Sipas presidentit Lambertz, kapaciteti kyç i kësaj ngjarjeje, është mobilizimi i rajoneve dhe qyteteve, dhe po aq sa rajonet kanë nevojë për Bashkimin European, edhe BE-ja ka nevojë për rajonet.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, si dhe promovimit të potencialeve të territorit të Qarkut Vlorë, kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë mori pjesë në aktivitetet e organizuara nga shoqata “Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë”, me tematikë Rruga Europiane midis Craiovas dhe Vlorës. Në këto aktivitete, morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të pushtetit vendor, si Prefekti i Qarkut Vlorë; kryetari i bashkisë Vlorë; rektori i universitetit “Is-mail Qemali” Vlorë; njëkohësisht edhe deputetë të Qarkut të Vlorës. Qëllimi kryesor i javës kulturore shqiptare, ishte



shkëmbimi dhe përçimi i vlerave të përbashkëta kulturore dhe historike; krijimi i urave të bashkëpunimit midis institucioneve lokale dhe rajonale të Craiovës dhe atyre të Vlorës.

Në këtë kuadër, Kryetari i Qarkut Vlorë realizoi takimin me kryetarin e qarkut Dolj, - ku Craiova është pjesë - z. Ion Prioteasa, me të cilin u diskutuan çështje të bashkëpunimit në programet europiane. Qarku Dolj ofronte një për-



vojë të gjatë dhe pozitive, në aspektin e hartimit dhe zbatimit të projekteve me fonde të BE-së, ndaj në këtë aspekt, u diskutua edhe mundësia e ndarjes së kësaj përvoje midis stafeve përkatëse teknike, përveç mundësive të bashkëpunimit në projekte të përbashkëta.

Në datat 4 deri më 10 nëntor, Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë mori pjesë në aktivitetin “Albania Yours to Invest”, që u organizua nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Britani e Madhe, me fokus nxitjen e investimeve në 12 qarqet e Shqipërisë. Sipas axhendës, si pjesë e delegacionit shqiptar, Kryetari u takua me deputetin laburist, z. John Grogan, në Parlamentin Britanik, i cili kishte në fokus progresin e Shqipërisë drejt Integritimit në Bashkimin Europian, si dhe mbi potencialet e saj ekonomike, veçanërisht në fushën e turizmit.

Takimi me një nga studiot më të mëdha, përfaqësuese të bizneseve ndërkombëtare me seli qendrore në Londër, ku u diskutuan lehtësirat fiskale dhe legislative për investimet strategjike në turizëm dhe energji të rinovueshme, investime në fushën e hotelierisë dhe turizmit, si dhe në agrobiznes, pati një interes të veçantë. Kryetari ofroi informacionin e përditësuar mbi prurjet turistike në portin e Sarandës dhe të Vlorës, si edhe mbi dy investimet e mëdha të qeverisë shqiptare: Ndërtimi i aeroportit të Vlorës në Novoselë dhe investimi mbi energjitë të rinovueshme në Akërnë të Vlorës - fituesi i së cilës, së fundmi, është lançuar nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.



Gjithashtu, Kryetari u prit së bashku me homologët e tij nga qarqet e tjera të Shqipërisë, në Këshillin e Hammersmith-it dhe Fulham-it, nga kryetarja e Bashkisë, znj. Daryl Brown, me të cilën u diskutua mbi rolin e Shqipërisë në rajon, reformat e ndërmarrja dhe vizioni për të ardhmen, zhvillimin e zonave urbane dhe rurale, duke adresuar edhe çështjet e ndërtimit të banesave sociale.

Kjo vizitë disaditore, u pasua edhe nga takime të tjera të fokusuara, më së shumti, në shkëmbimin e përvojave dhe përfitim të modeleve të suksesshme angleze, që kanë maskimizuar potencialet natyrore dhe kulturore për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.



Rajonet kufitare të Greqisë, janë partnerët strategjikë të Qarkut Vlorë, për propozime të përbashkëta në programin ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020, por edhe më gjerë. Për këtë qëllim, takimet me homologët dhe stafet përkatëse, si dhe me kryetarët e bashkive, ka qenë një prej prioriteteve të këtij viti, me qëllim diskutimin e propozimeve dhe shkëmbimin e përvojave e ngritjen e kapaciteteve, për të përfituar sa më cilësisht nga programi ndërkufitar.

Mbledhjet dhe vendimet e Këshillit të Qarkut Vlorë, për 2018

Organi ligjvënës i Këshillit të Qarkut Vlorë, është Këshilli i përbërë nga 28 këshilltarë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Bashkia
1	Dritan	Halil	Leli	Vlorë
2	Migena	Hysen	Balla	Vlorë
3	Mujo	Andon	Shakaj	Vlorë
4	Ervis	Vasil	Moçka	Vlorë
5	Baki	Avni	Jazaj	Vlorë
6	Bashkim	Memo	Bega	Vlorë
7	Rajmonda	Kamber	Zoto	Vlorë
8	Përparim	Neshet	Shametaj	Selenicë
9	Hektor	Bilbil	Gjoka	Selenicë
10	Adi	Luan	Sulçaj	Selenicë
11	Panajot	Thanas	Rrapaj	Selenicë
12	Jorgo	Sokrat	Goro	Himarë
13	Silvana	Thoma	Meçi	Himarë
14	Dhimitër	Riza	Kapaj	Himarë
15	Nikollaq	Andrea	Brigo	Himarë
16	Florjana	Nevruz	Koka	Sarandë
17	Feruz	Maksut	Basho	Sarandë
18	Landi	Qani	Hito	Sarandë
19	Dhimitraq	Andon	Lapa	Sarandë
20	Violeta	Hysejn	Taho	Sarandë
21	Rigers	Balil	Balili	Delvinë
22	Arbër	Feim	Zejnati	Delvinë
23	Harallamb	Thoma	Pandehi	Finiq
24	Adelina	Pando	Harizi	Finiq
25	Stavro	Llambi	Çeko	Finiq
26	Leonidha	Vasil	Hristo	Finiq
27	Shuaip	Veledin	Beqiri	Konispol

Mbledhjet dhe vendimet gjatë vitit 2018

Gjatë vitit 2018, Këshilli i Qarkut Vlorë është mbledhur katër herë

Në mbledhjen e datës 21.03.2018, u miratuan nga këshilli 18 vendime:

1. VKQ nr. 1 dt. 21.03.2018, “Për mbarimin e mandatit të këshilltarit të Qarkut, z. Sadrit Danaj”.

2. VKQ nr. 2 dt. 21.03.2018, Për miratimin e rregullores së brendshme, “Për menaxhimin e aktiviteteve për vitin 2018”.

3. VKQ nr. 3 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e tavaneve përgatitore për program, buxhetin afatmesëm 2019-2021”.

4. VKQ nr. 4 dt. 21.03.2018, “Për miratimin shtesë në buxhetin e Këshillit të Qarkut të vitit 2018, miratuar me V.K.Q. nr.33,dt.20.12.2017”.



5. VKQ nr. 5 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e buxhetit faktik 2017”.

6. VKQ nr. 6 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e aktmarrëveshjes, mbi kuotën e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut, nga bashkitë”.

7. VKQ nr. 7, dt. 21.03.2018, “Për përditësimin e rregullores së brendshme të funksionimit të administratës së K.Q.Vlorë, në bazë të strukturës për vitin 2018”.

8. VKQ nr. 8 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e pjesëmarrjes së Këshillit të Qarkut Vlorë në projektin “ADRINET”: Rrjeti Adriatik për Ekosistemin detar që do të zbatohet në kuadër të Programit INTEREG-IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2018.

9. VKQ nr. 9 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Vlorë”.

10. VKQ nr. 10 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre,

kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Sarandë“.

11. VKQ nr. 11 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Delvinë“.

12.VKQ nr. 12 dt. 21.03.2018, “Për sistemimin e fëmijës XH.B. në shtëpinë e fëmijës 0-6 vjeç Vlorë”.

13.VKQ nr. 13 dt.21.03.2018, “Për sistemimin e fëmijës XH.B. dhe S.T. në shtëpinë e fëmijës 0-6 vjeç Vlorë”.

14.VKQ nr. 14 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e linjave rrethqytetëse, bashkia Himarë”.

15.VKQ nr. 15 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e linjave rrethqytetëse, bashkia Konispol”.

16.VKQ nr. 16 dt. 21.03.2018, “Për miratimin e propozimit për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, të Hulusi Ferat Dizdarit”.

17.VKQ nr. 17 dt. 21.03.2018, “Për një ndryshim të këshillit administrativ të shoqërisë “Bajkaj Land” sh.a.”.

18.VKQ nr. 18 dt. 21.03.2018 “Për emërimin e audituesit ligjor - ekspertit për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të shoqërisë “Bajkaj Land” sh.a., për vitin 2017”.

Në mbledhjen e datës 27.06.2018, këshilli ka miratuar 10 vendime:

1. VKQ nr. 19 dt. 27.06.2018, “Për dhënien e mandatit të këshilltarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, z. Mujo Andon Shakaj”.

2. VKQ nr. 20 dt. 27.06.2018, “Për miratimin e projektprogramit buxhetor afatmesëm 2019 - 2021, të Këshillit të Qarkut Vlorë”.

3. VKQ nr. 21 dt. 27.06.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara



deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Vlorë”.

4.VKQ nr. 22 dt. 27.06.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Himarë.”

5.VKQ nr. 23 dt. 27.06.201, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre- bashkia Delvinë”.

6.VKQ nr. 24 dt. 27.06.2018, “Propozim për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror, z. Uran Remzi Xhafa”.

7.VKQ nr. 25 dt. 27.06.2018, “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Këshillit të Qarkut dhe shoqërisë Bajkaj Land sh.a. për funksionimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të specializuara, të destinuara për tu përdorur për stacionin e transferimit të mbeturinave në Himarë”.

8.VKQ nr. 26 dt.27.06.2018, “Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes së Tokës, Qarku Vlorë”.

9.VKQ nr. 27 dt. 27.06.2018, “Për autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë të nënshkruajë marrëveshjet e bashkëpunimit, planet e prokurimeve dhe kontratat për projektet e fituara ndërkufitare”.

10. VKQ nr. 28 dt. 27.06.2018, “Për miratimin e Pasqyrave financiare të shoqërisë Bajkaj Land sh.a., për vitin 2017”.

Në mbledhjen e datës 28/09/2018 këshilli ka miratuar 15 vendime:

1. VKQ nr. 29 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, 2019-2021”.

2. VKQ nr. 30 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019 – 2021, të rishikuar të Këshillit të Qarkut”.

3. VKQ nr. 31 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e Marrëveshjes së Shkëmbimit, midis Këshillit të Qarkut dhe bashkisë Vlorë”.

- 4.VKQ nr. 32 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e Transferimit të Aktiveve bashkisë Vlorë”.
5. VKQ nr. 33 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri me 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Vlorë”.
- 6.VKQ nr. 34 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri me 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Himarë”.
- 7.VKQ nr. 35 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e vendimeve për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri me 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie dhe për regjistrimin e tyre - bashkia Delvinë”.
- 8.VKQ nr. 36 dt. 28.09.2018, “Për dhënien e titullit vendor “Nderi i Qarkut Vlorë, z. Skënder Tena”.
- 9.VKQ nr. 37 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e propozimit për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror z.Abaz Kalo Arapi”.
- 10.VKQ nr. 38 dt. 28.09.2018, “Për sistemimin e fëmijëve E.M., F.S. dhe A.T., në shtëpinë e fëmijës shkollor, “Vangjel Pulla-Sarandë”.
- 11.VKQ nr. 39 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e Marrëveshjes Operacionale, ndërmjet ministrisë së Europës dhe Punët e Jashtme dhe Këshillit të Qarkut Vlorë”.
- 12.VKQ nr. 40 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e marrëveshjes midis Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Dhomës Britanike të Tregtisë, me qëllim krijimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm midis dy vendeve tona, në kuadër të tërheqjes së investimeve britanike në Shqipëri”.
- 13.VKQ nr. 41 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e linjës rrethqytetëse - bashkia Sarandë”.
- 14.VKQ nr. 42 dt. 28.09.2018, “Për miratimin e linjave rrethqytetëse - bashkia Himarë”.
- 15.VKQ nr. 43 dt. 28.09.2018 “Për miratimin e Planveprimet për ngushticën e Otrantos dhe Korfuzit- Projekti PASSAGE”.

Investimet e realizuara gjatë vitit 2018, nga buxheti i qarkut Vlorë

Për vitin 2018, janë planifikuar 3 investime me buxhetin e qarkut Vlorë, në funksion të njërive vendore. Këto investime janë planifikuar edhe në kuadër të zhvillimit të Programit të Menaxhimit të Burimeve Natyrore (BNB), program i hartuar nga stafi i qarkut dhe i miratuar nga Këshilli, në vitin 2015. Kështu, stafi i qarkut - pasi ka identifikuar dhe vlerësuar nevojat dhe prioritetet - ka hartuar plotësisht tre projekte, midis të cilave njëra është realizuar dhe të dy të tjerat janë në proces të procedurave për zbatim.

I- Rikualifikimi i Çezmës në fshatin Drashovicë, Vlorë

Çezma e Drashovicës ndodhet në sheshin përballë monumentit të fshatit. Nga vitet 1800, banorët jetonin pranë minierës së Strallit në fshatin e vjetër, rrënojat e të cilit gjenden edhe sot. Pas vitit 1912, banorët u shpërngulën te sheshi, ku kishte shumë prurje të burimeve ujore, ku uji ishte i pastër dhe shumë i ftohtë. Me shtimin e popullsisë, u ndërtua ura dhe çezma e fshatit. Këshilli i Qarkut Vlorë, sipas kërkesës së komunitetit, ka miratuar dhe investuar në rikualifikimin e sheshit, për t'i dhënë më shumë gjallëri jetës së banorëve të fshatit. Gjatë zbatimit të këtij projekti, u ruajtën vlerat e mjedisit përreth, duke shtuar edhe sipërfaqet e gjelbërta me mbjelljen e pemëve me kurorë të gjerë, për krijimin e mjediseve të freskëta dhe relaksuese për këdo. Sheshi sot, paraqitet si një vend qetësues, me pemë, stola dhe ndriçim.

Gjendja para ndërhyrjes



Situata pas ndërhyrjes



2 - “Ndërtimi i Kullave të Vrojtimit në Lagunën e Nartës, Vlorë

Qëllimi i këtij projekti, është përmirësimi i infrastrukturës informuese, nëpërmjet ndërtimit të disa kullave të vrojtimit, të cilat kanë si qëllim zhvillimin e aktiviteteve të vrojtimit të zogjve (birdwatching).

Si parashikohet të ndërtohet



3- Ndërhyrje rehabilituese në fushën e sportit NJ.A. Novoselë, Vlorë


Qëllimi i këtij projekti, është përmirësimi i cilësisë së hapësirave publike, duke nxitur përdorimin e tyre me qëllim socializimin dhe integrimin social dhe marrëdhëniet ndërmjet brezave; konkretisht, të krijohen kushte të përshtatshme

për realizimin e aktiviteteve sportive në kushte normale, në fushën sportive të NJ.A. Novoselë.

Gjendja ekzistuese



Si parashikohet të bëhet



Programi i zhvillimit

Projektet e BE-së

Këshilli i Qarkut Vlorë është përfutues i shtatë projekteve me fonde të Bashkimit European, në 3 programet:

1. Programi INTERREG IPA II, Greqi-Shqipëri 2014-2020;
2. Programi INTERREG IPA II, Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020;
3. Programi INTERREG Europe.

Programi INTERREG IPA II Greqi-Shqipëri 2014-2020

Këshilli i Qarkut Vlorë është përfshirë në 2 thirrjet e këtij programi dhe është vlerësuar fitues në partneritetet për dy projekte strategjike nga thirrja e parë dhe tre projekte nga thirrja e dytë.

Pas firmosjes së kontratave dhe marrëveshjeve të partneritetit, të gjitha këto projekte kanë nisur zbatimin e tyre në vitin 2018. Faza e parë e zbatimit të këtyre projekteve, ka nisur me lançimin e fillimit të zbatimit të tyre, takimet e para kick off dhe procedurat administrative për hapjen e llogarive bankare të dedikuara për çdo projekt, analizën e situatës aktuale - sipas tematikave që projektet janë të fokusuara - dhe përgatitjen e dosjeve të ekspertëve.

Projektet strategjike: Thirrja I

REAGO PËR MBETJET / WASTE REACT:

Menaxhimi i mbetjeve përmes rritjes së riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve, në 7 rajonet ndërkufitare greke dhe shqiptare

Partneret:

- Rajoni i Epirit, Greqi
- Rajoni i Ishujve Joniane, Greqi
- Qendra e Menaxhimit të Mbetjeve për Maqedoninë Perendimore, Greqi

- Qendra për kërkim dhe teknologji, Greqi
- Qarku Gjirokastrë, Shqipëri
- Qarku Korçë, Shqipëri
- Qarku Vlorë, Shqipëri
- Qarku Berat, Shqipëri

Ky projekt ka për qëllim të mbështesë ndërtimin e infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe promovimin e mbrojtjes së mjedisit, si dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, në të shtatë rajonet ndërkufitare. Pritet që, më shumë se 10.000 ton i mbeturinave të ngurta, të trajtohen në mënyrë të qëndrueshme, përmes kompostimit dhe riciklimit gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit dhe për të gjithë territorin që mbulojnë partnerët e projektit.

Projekti për qarkun e Vlorës, është parashikuar të zbatohet në bashkëpunim me tri bashkitë - Finiq, Delvinë dhe Konispol - në bashkëpunim me ndërrmarjen menaxhuese të landfilledit sanitar “Bajkaj Land” dhe konsiston në pajisjen e bashkive dhe landfilledit me mjetet përkatëse për menaxhimin e mbetjeve, makineri teknologjike, kosha riciklues dhe krijimin e një skeme të re për riciklimin e mbetjeve, që do depozitohen në landfill, në bashkëpunim me kompani ricikluese që operojnë në vend. E gjithë kjo, do të shoqërohet me një fushatë ndërgjegjësuere për banorët e bashkive përkatëse, nxënësit e shkollave dhe publikun e gjerë.

Takimi i parë i këtij projekti, është realizuar në tetor 2018



KURSE UJIN / SAVE WATER:

Përmirësimi i menaxhimit të ujit dhe infrastrukturës së furnizimit me ujë, përmes teknologjisë SMART, politikave dhe instrumenteve.

Partneret:

- Rajoni i Ishujve Jonianë, Greqi
- Rajoni i Epirit, Greqi
- Qarku Vlorë, Shqipëri
- Qarku Korçë, Shqipëri
- Qendra e mjedisit – rajoni i Maqedonisë Perëndimorë, Greqi
- Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve të Janinës, Greqi
- Universiteti Jonian - Komiteti i Kërkimit, Greqi
- Universiteti i shkencave të aplikuara në Maqedoninë Perëndimore, Greqi

Objektivi kryesor i projektit është rritja e kapacitetit të infrastrukturës ndërkufitare në menaxhimin e ujit përmes planifikimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm duke përmirësuar monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

Rezultati i pritshëm është përmirësimi i kapacitetit të monitorimit prej autoriteteve rajonale dhe vendore nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknologjike me kosto të ulët – vendosjen e sensorëve në infrastrukturën ekzistuese të furnizimit me ujë të pijshëm, me qëllim reduktimin e humbjes së ujit, matjen dhe monitorimin e presioneve dhe humbjeve të shkaktuara nga njerëzit apo edhe ndryshimet klimatike.

Ky projekt për qarkun e Vlorës, do të zbatohet në njësinë administrative Novoselë në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë. Aktualisht në sistemin e furnizimit me ujë në Novoselë komandimi i saraçineskave për lëshimin e ujit është i pakontrolluar, çka sjell për pasojë humbje, si në sasinë-prurjen dhe presionin e ujit, të cilat ndikojnë në zvogëlimin e presioneve dhe sasisë së ujit në pjesën fundore të linjës kryesore të ujësjetës. Shpesh në zonat e banimit, në pjesën fundore të linjës së tubit ujësjetës nuk ka ujë dhe presioni bie shumë.

Për këtë qëllim, ky projekt do të ndërhyjë në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm në segmentin Novosele-Fitore, ka do të instalohen dhe do të lidhen me sistemin SCADA në 12 nyjet kryesore reduktorë dhe matës uji për të përmirësuar gjendjen aktuale, gjithashtu do të rregullojë gjendjen e gjashtë puseve dhe stacionet përkatës të pompimit. Në këtë pjesë të ndërhyrjes do të

instalohen sensorë të matjes së sasisë dhe cilësisë së ujit që do të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me qendrën elektronike të kontrollit që do të instalohe në qendrën e shpërndarjes. Është parashikuar gjithashtu një qasje inovative përmes një aplikacioni në celular, ku çdo qytetar do të ketë të drejtën të njihet me gjendjen e furnizimit me ujë në kohë reale. Një pjesë e rëndësishme e këtij projekti është trajnimi i administratës së ndërrmarjes së ujësjellësit dhe bashkisë Vlorë për njohjen dhe mbikëqyrjen përmes teknologjisë SMART të furnizimit me ujë të pijshëm në këtë zonë pilotimi.

Takimi i parë i këtij projekti është realizuar në korrik 2018.



Projektet dytësore: Thirrja II

PhaRem: Zhvillimi i një sistemi inovativ për trajtimin e mbetjeve spitalore

Partnerët:

- Universiteti i Janinës, Greqi
- Rajoni i Decentralizuar i Epirit dhe Maqedonisë Perëndimore, Greqi
- Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
- Qarku Vlorë, Shqipëri
- Spitali Rajonal Vlorë, Shqipëri

Qëllimi i projektit është zhvillimi dhe aplikimi i një sistemi të bazuar në pro-

cesin e oksidimit të avancuar për trajtimin e ujërave të ndotura spitalore që do të largojë komponimet farmaceutike me qëndrueshmëri të lartë në mjedisin ujor.

Duke marrë në konsideratë rolin dhe funksionin e Këshillit të Qarkut Vlorë, përvojën e mëparshme në zbatimin e projekteve si dhe kriteret e partneritetit në këtë projekt specifik, qarku i Vlorës do të kontribuojë në koordinimin e palëve të interesuara, organizimin e takimeve të projektit dhe aktiviteteve informuese, promovimin e rezultateve në të gjithë territorin si dhe në krijimin e një klime bashkëpunimi në nivel rajonal midis institucioneve të Spitalit Rajonal Vlorë dhe Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe në nivel ndërkufitar me partnerët grekë.

Bashkëpunimi në një kontekst rajonal dhe ndërkufitar i partnerëve të këtij projekti do të shërbejë në përmirësimin dhe zhvillimin e veprimeve të përbashkëta për kontrollin dhe mbrojtjen e mjedisit, në zhvillimin e një teknologjie inovatore të trajtimit të përbërësve farmaceutikë në ujërat e zeza spitalore, si edhe në krijimin e skemave pozitive të bashkëpunimit ndërkufitar dhe qëndrueshmërisë së rezultateve të projektit.

Takimi i parë i këtij projekti është realizuar në 8 tetor 2018.



E-HORECA WANET:

Menaxhimi eficient i mbetjeve të hoteleve kateringut në zonat turistike

Partnerët:

- Universiteti Jonian, Greqi
- Bashkia e Korfuzit, Greqi
- Qarku Vlorë, Shqipëri
- Bashkia Sarandë, Shqipëri
- Universiteti Kombëtar Teknik i Athinës, Shqipëri

Qëllimi i projektit është menaxhimi i prurjeve intensive të mbeturinave urbane në zonat turistike sidomos gjatë periudhës së muajve të verës. Rezultatet e këtij projekti do të mbështeten në krijimin e një sistemi informativ për menaxhimin dinamik dhe në kohë të mbetjeve urbane.

Takimi i parë i këtij projekti është realizuar në nëntor 2018.

3- KULTURA E ULLIRIT:

Kontributi në rritjen e sektorit të ullirit, duke promovuar praktikatat e e mira të kultivimit

Partnerët:

- Bashkia e Nikolaos Skoufas, Greqi
- Instituti i Edukimit Teknologjik të Epirit, Greqi
- Universiteti Jonian, Greqi
- Qarku Vlorë, Shqipëri
- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, Shqipëri
- Bashkia Berat, Shqipëri

Qëllimi është krijimi i një rrjeti ndërkufitar për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave pozitive që do të çojë në zhvillimin e një menaxhimi praktik të kultivimit të ullirit dhe mjeteve tregtare të produkteve përkatëse.

Fokusi i punës së institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë në këtë projekt do të lidhet kryesisht me promovimin dhe rrjetëzimin, mbështetjen për marketimin dhe brandimin e produktit përmes një qendre për shërbimet mbështetëse për agrobiznesin për prodhuesit lokalë dhe specialistët agronomë.

Ende nuk është realizuar takimi parë zyrtar i projektit, për shkak të disa modifikimeve në partneritet të kërkuara rishtas nga partnerë të palës greke.

Programi INTERREG IPA II Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020

Në thirrjen e parë të programit trilateral, Këshilli i Qarkut Vlorë u paraqit me

disa propozime, prej të cilëve u vlerësua pozitivisht për të qenë zbatues i një projekti që trajton çështje që lidhen me peshkimin.

“ADRINET: Rrjeti Adriatik për Ekosistemin Detar”.

Projekti **ADRINET** i fokuson veprimet në përmirësimin e një plani të përbashkët trilateral për ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemit detar në rajonin e Pulias, në qarkun e Vlorës dhe në zonën e Herceg Novit e Kotorit në Malin e Zi përmes trajtimit të fenomenit të “peshkimit fantazëm”. Ky fenomen ndodh atëherë kur peshkatarët humbasin, hedhin apo braktisin rrjetat dhe çdo material tjetër të përdorshëm për të kapur peshk në det. Rrjetat e peshkimit dhe çdo material tjetër i prodhuar nga njeriu që përdoret për kapjen e peshqve dhe organizmave të tjerë detarë bëhen objekt i peshkimit fantazëm, në rastet kur nuk mbikëqyren me përgjegjësi dhe bëhen “kurthe” për peshqit dhe për të tërhequr si në një rreth vicioz të tjerë organizma detarë, duke rezultuar në stoqe të tëra të peshqve të zhdukur. Materiali i përdorur për pajisjet e peshkimit kërkon dekada të tëra deri edhe shekuj për t’u shpërbërë, duke shkaktuar ndotje të mjedisit detar.

Në funksion të ofrimit të alternativave më të mira për zgjidhje, qoftë edhe një praktike të përbashkët pozitive për këtë çështje, projekti **ADRINET** ka parashikuar përcaktimin e një strategjie të përbashkët për trajtimin e fenomenit në zonat e përfituesve si dhe iniciativës së veprimeve pilot, me rezultate konkrete. Nga ana tjetër projekti do të ofrojë shërbime, mbështetje shkencore dhe trajnime për komunitetin e peshkatarëve në veçanti dhe të publikut konsumator në tërësi. Qëllimi i projektit është forcimi i bashkëpunimit ndërkuftar mbi çështjet detare, përmes përcaktimit të protokolleve e mjeteve të përbashkëta të menaxhimit të peshkimit.

Objektivat:

1. Krijimi i një rrjeti ndërkuftar midis partnerëve në lidhje me praktikën më të mira mbi peshkimin, specifikisht në shfrytëzimin dhe kontrollin e peshkimit fantazëm.
2. Krijimi i një grupi të qëndrueshëm Task Force mbi çështje të peshkimit dhe zbatimi i qendrave të referencës për të dhënë mbështetje teknike dhe për të mbledhur të dhëna mbi peshkimin dhe akuakulturën.
3. Transferimi i aftësive të përditësuara të ekspertëve të peshkimit në lidhje me kontrollin mikrobiologjik dhe kimik të ujit të detit.
4. Përcaktimi i një sistemi gjurmues dhe parandalues për peshkimin fantazëm.

5. Zbatimin e një strategjie të përbashkët për të luftuar fenomenin e peshkimit fantazëm duke pastruar fundit e detit, sidomos në zonat me ndjeshmëri të lartë mjedisore.

6. Promovimi i peshkimit duke informuar publikun e gjerë dhe orientuar konsumatorin.

Partnerët:

- Universiteti i Studimeve në Bari, Itali
- Bashkia e Kastros, Itali
- Bashkia e Herceg Novi, Mal i Zi
- Universiteti në Kotorr, Mal i Zi
- Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri
- Këshilli i Qarkut Vlorë, Shqipëri

Në këtë projekt, qarku Vlorë do të përfshihet në zbatimin e 5 paketave të punës:

- **Paketa 1:** Menaxhimi dhe koordinimi i aktiviteteve të projektit përmes pjesëmarrjes në takimet e projektit dhe realizimit e zbatimit të planit të komunikimit.
- **Paketa 2:** Promocioni përmes fushatës ndërgjegjësuese për publikun e gjerë në median lokale dhe kombëtare, realizimit të fletëpalosjeve dhe posterave informues.
- **Paketa 4:** Krijimi i një këndi informues dhe trajnues për komunitetin e peshkatarëve për çështje që lidhen me peshkimin fantazëm. Kjo paketë do të synojë edhe realizimin e një ankete për identifikimin e rrugëve dhe vendeve të peshkimit, të dhëna që do të transformohen elektronikisht në një hartë GPS.
- **Paketa 5:** Ralizimi i një Marrëveshje të Përbashkët Mirëkuptimi midis tre vendeve duke u fokusuar në politikat multilaterale dhe ndërkuftare për çështjen e peshkimit fantazëm.
- **Paketa 6:** Kjo paketë parashikon veprimet pilot që do të synojnë pastrimin e zonës së përcaktuar detare nga rrjetat me ndihmën e anijeve të peshkimit dhe grupeve të zhytësve që do të përfshihen në projekt. Përmes kësaj pakete do të realizohet edhe një sistem GPS që do facilitojë gjithë veprimet e kësaj faze si edhe pajisjen e rrjetave të peshkatarëve me mikroçipe për monitorimin dhe ndërhyrjet e nevojshme edhe pas përfundimit të projektit.

Takimi i parë i projektit është realizuar në maj 2018.



Programi INTERREG Europe

Në maj 2016, Këshilli i Qarkut Vlorë u përfshi si partner i asociuar në projektin

“PASSAGE: Ulja e CO₂ në transportin detar dhe tokësor në rajonet kufitare detare”.

Ky projekt trevjeçar, erdhi si rezultat i përfshirjes dhe angazhimit të institucionit në Rrjetin e Ngushticave Detare (ESI), krahas rajoneve të vendeve të Unionit, prej vitit 2010.

Qëllimi i këtij projekti është shkëmbimi i përvojave, iniciativave dhe modeleve të suksesshme në reduktimin e CO₂ në 8 rajonet kufitare detare, me fokus ekonominë e qëndrueshme në rajon.

Kështu, praktikat pozitive të identifikuar nga çdo partner, janë bërë të njohura gjatë kësaj kohe në takimet e zhvilluara në secilin rajon që përfaqëson një ngushticë detare, si në aspektin teknik, ashtu edhe të vizitave në terren.

Në nëntor të vitit 2018 partnerët e projektit **PASSAGE** u pritën në Vlorë, me qëllim diskutimin e planeve të veprimit të realizuar në kuadër të këtij projekti. Këshilli i Qarkut Vlorë u prezantua me Planin e Veprimit të hartuar në përditësim dhe progres të Planit Strategjik 2011-2020 “Emetime 0”. Duke konsideruar të rëndësishme vizitat në terren, me qëllim që të kuptohej më mirë situata aktuale

në rajonin e Vlorës dhe në Shqipëri, u planifikua vizita në terren në portin e Vlorës, zonën e mbrojtur detare Karaburun-Sazan dhe parkun kombëtar të Llogarasë. Partnerët e projektit **PASSAGE** udhëtuan në parkun detar kombëtar të Karaburun-Sazanit për të parë në vend se si zbatohet kjo praktikë e mirë. Menaxhimi i kësaj zone detare, e cila është e vetmja zonë e mbrojtur detare është vendi, ishte identifikuar tashmë si një nga praktikatat më të mira të projektit.



Në kuadër të programit të zhvillimit stafi i Këshillit të Qarkut Vlorë, të angazhuar më së shumti me projektet INTERREG, ka qenë pjesëmarrës aktiv në të gjitha takimet e organizuara nga strukturat menaxhuese të programeve, në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, takime që kanë shërbyer për ngritjen e kapaciteteve të stafit në përfshirjen dhe menaxhimin e projekteve. Gjithashtu janë trajtuar nga ana e stafit çështje të diskutueshme dhe janë ofruar rekomandime në përmirësimin dhe lehtësimin e aksesit dhe zbatimit korrekt të këtyre projekteve, veçanërisht për institucionet publike.

Projekti “Asistencë direkte për gra e vajza, viktime të trafikimit, të mundshme trafikimi dhe në rrezik në qarkun e Vlorës”

Bazuar në vendimin Nr. 9, datë 11.03.2015 dhe me financim të ish Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, sot Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Qarkut Vlorë ka mbështetur prej muajit mars 2015 dhe në vazh-

dim qendrën Psiko-Sociale “Vatra” në Vlorë për zbatimin e projektit “Asistencë direkte për gra e vajza, viktime të trafikimit, të mundshme trafikimi dhe në rrezik në qarkun e Vlorës”.

Qendra Psiko-Sociale “Vatra” është një organizatë jo-fitim prurëse që operon në qarkun e Vlorës dhe në një nivel kombëtar prej mbi 18 vjet në fushën e shërbimeve sociale, të fokusuar në trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhunën në familje. Vatra ofron këto programe:

1. Parandalimin e trafikut njerëzor dhe dhunës me bazë gjinore/Infomim-Edukim.
2. Asistencë direkte për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktime të dhunës në familje
3. Fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve të strukturave shtetërore dhe OJF me qëllim zbatimin efektiv të politikave kombëtare antitrafikim dhe kundër dhunës.
4. Lobim dhe advokaci në mbrojtje të të drejtave të grave, vajzave dhe fëmijëve.

SHËRBIMET

- Akomodimi/strehimi
- Siguria 24 orë
- Vlerësim i nevojave
- Asistencë shëndetësore
- Asistencë dhe mbështetje psiko-sociale
- Asistencë dhe këshillim ligjor
- Edukim dhe mbështetje shkollore
- Ndërmjetësim dhe mbështetje për formim profesional
- Këshillim/ndërmjetësim për punësim
- Trajnim në punë
- Fuqizim i marrëdhënieve me familjen
- Aktivitete të kohës së lirë
- Mbështetje për jetesë gjysmë të pavarur në apartamente me qera
- Mbështetje për hapjen e mikrobizneseve
- Monitorim dhe follow-up

DONATORËT

- MMRS - "Ofrimi i asistencës direkte për fuqizimin social dhe ekonomik të viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në Qarkun e Vlorës"
- CIES - "GEMAL -Integrimi gjinor në Shqipëri- me gratë kundër dhunës dhe shfrytëzimit"
- AWEN - "Ofrim i asistencës riintegruese të qëndrueshme për ish viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit në Shqipëri"
- Vital Voice - "Gratë në programe të zhvillimit dhe biznesit"
- DAP - Fuqizimi socio-ekonomik i grave dhe vajzave viktime të trafikimit/viktima të mundshme të trafikimit për riintegrim të suksesshëm social"

Projekti “Asistencë direkte për gra e vajza, viktime të trafikimit, të mundshme trafikimi dhe në rrezik në qarkun e Vlorës” konsiston në ofrimin e pagesave të stafit të qendrës që asiston dhe trajton viktimat në programin e rehabilitimit dhe ri-integritimit. Kështu, gjatë 9-mujorit të vitit 2018 Vatra ka asistuar në total 82 përfituese

dhe 41 fëmijë të tyre; 28 përfituese dhe 13 fëmijet e tyre janë mbështetur me shërbime në strehëz, dhe 54 përfituese dhe 28 fëmijët e tyre janë mbështetur me shërbime në fazën e dytë dhe të tretë të programin në komunitet.

Bazuar në ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetë qeverisjen Vendore”, nenet 12, 13 dhe në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005” Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, neni 30, në zbatim të kërkesave të VKM nr.563, datë 12.08.2005, me vendim nr. 9, datë 11.03.2015 për projektin “Asistencë direkte për gra e vajza, viktima të trafikimit, të mundshme trafikimi dhe në rrezik në qarkun e Vlorës.” Këshilli i Qarkut Vlorë monitoron dhe raporton çdo tre muaj në Ministrinë e Shëndetësisë. Këshilli i Qarkut Vlorë ka shprehur kërkesën për vazhdimin e financimit të shërbimit rezidencial për të siguruar vijueshmërinë e shërbimeve cilësore rezidenciale dhe komunitare, në zërin paga dhe sigurime shoqërore, për 12 punonjësit e drejtpërdrejtë për vitin 2019 (Janar –Dhjetor).

Zhvillimi i partneriteteve

Këshilli i Qarkut Vlorë është anëtar në disa koalicione dhe rrjete lobuese me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Qëllimi i përfshirjes në këtë rrjete është rritja e vizibilitetit dhe promovimit të qarkut Vlorë dhe gjenerimi i iniciativave dhe investimeve për një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të territorit.

Iniciativa Europiane e Ngushticave Detare (ESI)

KQ Vlorë është anëtar i Inisiativës së Ngushticave Detare prej vitit 2010, vit i lançimit të këtij rrjeti nga partnerët liderë, rajoni i Pas de Calais në Francë dhe rajoni i Kentit në Angli. Në përberje të këtij rrjeti janë 19 rajone europiane që ndajnë ngushticat detare europiane: ngushticën e Kvarken, Bonifacios, Otrantos, Siçilisë, Korfuzit, Gjibraltarit, Doverit, Kentit, Mesinës, Fehrmarn Beltit, gjirit të Finlandës dhe kanalit të Korsikës. Kjo iniciativë lobuese synon njohjen e karakteristikave të veçanta të ngushticave europiane në kuadër të politikave europiane dhe integrimin e tyre përmes veprimeve të zbatuara sipas pro-



grameve europiane. Si rezultat i përfshirjes në këtë rrjet qarku Vlorë ka qenë pjesë e dy projekteve: Projekti NOSTRA (2011-2014) dhe projekti PASSAGE (2016-2019).

Komiteti i Përbashkët i Monitorimit të Programit Ndërkufitar Greqi-Shqipëri

KQ Vlorë është anëtar i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit të programit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020 me të drejtën e votës për procedurat e vlerësimit cilësor të programit sipas Nenit 38, të Rregullores së Komisionit për Zbatimin Nr 447/2014 dhe nenit 49 dhe 110, të Rregullores (BE) No 1303/2013. Në vitin 2018 është realizuar një takim i komitetit në Prevezë, Greqi dhe gjatë gjithë periudhës është zhvilluar komunikimi përmes linjës elektronike me Sekretariatit e Përbashkët Teknik dhe Autoritetin Menaxhues në Greqi. Këshilli i Qarkut Vlorë ka qenë aktiv në vendimet e ndryshme që Komiteti ka marrë, ashtu si edhe në aspektin e ofrimit të sugjerimeve, detaje që kanë dalë gjatë punës si përfitues, në bashkëpunim edhe me përfitues të tjerë, kryesisht të palës shqiptare.

EuroRajoni Adriatiko-Jonian

EuroRajoni Adriatiko-Jonian përfaqëson një model bashkëpunimi të nivelit trans-kombëtar dhe ndër-rajonal ndërmjet rajoneve të bregdetit Adriatik. EuroRajoni Adriatiko-Jonian është korniza institucionale për përcaktimin dhe zgjidhjen e përbashkët të çështjeve të rëndësishme në zonën e Adriatikut. Ai përbëhet nga 26 anëtarë që përfaqësojnë qeveritë rajonale dhe lokale nga Italia, Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Shqipëria. Këshilli i Qarkut Vlorë është një prej anëtarëve nga Shqipëria që përfaqësohet në bazë të prioriteve të zhvillimit rajonal. Në kuadër të këtij rrjeti qarku Vlorë ka qenë pjesëmarrës aktiv në tryezën e diskutimit për çështjet detare në detin Adriatik “Adriatiku, deti që bashkon vepërimin për mbikëqyrjen dhe garantimin e sigurisë detare”.

Asambleja Europiane e Rajoneve (AER)

Asambleja Europiane e Rajoneve (AER) është një organizim që sjell së bashku rajonet, me qëllim forcimin dhe rritjen e tyre përmes shkëmbimit të praktikave më të mira. Në vitin 2018 është përditësuar antarësimi i qarkut Vlorë në këtë asamble, duke e bërë më të dukshëm dhe më aktiv institucionin në aktivitetet e ndryshme që AER ka zhvilluar gjatë këtij viti. Gjithashtu, si rezultat i propozimit

dhe votimit unanim kryetari i qarkut Vlorë z. Ervis Moçka është zgjedhur anëtar i Byrosë së Asamblesë.

Në zgjedhjet e reja për byronë e Akademisë Evropiane të Rajoneve për periudhën 2018-2020 është nominuar dhe zgjedhur kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, si përfaqësues për rajonet shqiptare, krahas kryetares së Këshillit të Qarkut Korçë. Byroja është zëri kryesor politik i AER që angazhohet në çështje të një natyre paneuropiane dhe globale dhe krijon bazën politike për punën e advokimit të AER.



Akademia Europiane e Rajoneve

Akademia Europiane e Rajoneve është një shoqatë ndërkombëtare jo-fitimprurëse dhe jo-politike e themeluar në vitin 2014 në Bruksel, Belgjikë. Qëllimi i Akademisë Evropiane të Rajoneve është të promovojë idenë e rajonalizimit dhe të veprimit rajonal si një mjet për punësimin dhe përmirësimin të cilësisë së jetës. Organizata mbështet bashkëpunimin midis autoriteteve rajonale dhe lokale të shteteve anëtare, shteteve fqinje dhe vendeve të treta. Këshilli i Qarkut Vlorë iu

bashkua këtij organizmi në vitin 2017 me fokusin e qartë të mbështetjes prej AER për shqyrtimin e mundësive për zhvillimin rajonal të turizmit duke u përqendruar në pasuritë historike dhe natyrore të rajonit si dhe në ngritjen e kapaciteteve të nënpunësve civilë lokalë për hartim dhe zbatim të propozimeve të ndryshme në kuadër të programeve europiane.

Në bashkëpunim me Akademinë Europiane të Rajoneve dhe CRLDS Shqipëri, Këshilli i Qarkut Vlorë ka mbështetur për të tretin vit organizimin e forumit për Ballkanin Perëndimor. Ky është një forum tre-ditor ku diskutohen politikat lokale dhe rajonale të zhvillimit ekonomik në Ballkanin Perëndimor me pjesëmarrjen e përfaqësuesve politikë, të fushës akademike, ekspertë të ndryshëm, si dhe përfaqësues nga biznesi dhe shoqëria civile në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.



Shoqata e Këshillave të Qarqeve

Këshilli i Qarkut Vlorë është anëtar i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, kryetar i së cilës është z. Aldrin Dalipi, njëkohësisht kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë. Si pjesë e shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë,



kryetari i i qarkut Vlorë ka përfaqësuar dhe ka prezantuar sfidat dhe propozimet e qarqeve shqiptare në tryeza të përbashkëta pune, si në takimet e Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore - Vetëqeverisje Vendore, ashtu edhe në tryeza të tjera të përbashkëta të nivelit ndërkombëtar.

Shërbimet e drejtpërdrejta ndaj qytetarit

Titujt e Nderit

Komisioni Këshillimor për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë, mbështetur në dispozitat ligjore si dhe në Urdhërin Nr.55, datë 02.07.2018 "Për ngritjen e Komisionit Këshillimor për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë" të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, në mbledhjen e parë ka zgjedhur kryetarin dhe sekretaren e Komisionit. Në mbledhjen e dytë Komisioni ka shqyrtuar kërkesën e bërë nga përfaqësues të Shoqatës Atdhetare Kulturore Ramicë – Smokthinë, duke duke vendosur dhënien e titullit "Mirënjohje e Qarkut Vlorë" shkollës "Sadik Zotaj" Ramicë si dhe 5 (pesë) ish drejtuesve dhe mësuesve të saj. Po në këtë mbledhje komisioni shqyrtoi edhe kërkesën e përbashkët të Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro Marko" Vlorë, Shoqatës Kulturore "Labëria" Dega Vlorë dhe Shoqatës Kulturore Mbarëkombëtare "Ismail Qemali" Vlorë duke vlerësuar me titullin: "**Mirënjohje e Qarkut Vlorë**" 7 (shtatë) personaliteteve sipas fushave që këta kanë dhënë kontribut. Gjithashtu, me kërkesë të shoqatës atdhetare kulturore "Vërmiku" komisioni ka vlerësuar me titullin "*Mirënjohje e Qarkut Vlorë*" edhe 4 (katër) personalitete që kanë kontribuar në çlirimin e vendit. Kështu, numri total i titujve "*Mirënjohje e Qarkut Vlorë*" për vitin 2018 është 17.

Gjithashtu, me kërkesë të Fondacionit Kulturor Mbarëkombëtar "Nermin Vlora Falaschi" & Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro Marko" Vlorë dhe me propozim të Komisionit Këshillimor për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit është vlerësuar z. Skënder Tena me titullin "Nderi i Qarkut Vlorë" me motivacion: "*Skulptor i dalluar i Vlorës, me kontribut dhe krijimtari me nivel të lartë etiko - artistik, gur themeli për jetën artistike dhe krijuesit e rinj*".

Linjat rrethqytetëse

Këshilli i Qarkut, në bazë të ligjit nr 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar, dhe me kërkesë të njëjësive vendore të qarkut miraton linjat rrethqytetëse pranë njëjësive vendore përkatëse. Kështu, për vitin 2018, me kërkesë të njëjësive vendore janë miratuar në mbledhjet e këshillit këto linja rrethqytetëse:

Bashkia Sarandë:

Linja Sarandë-Livadhja-Sarandë sipas orareve përkatëse

Bashkia Konispol:

Linja Xarrë-Sarandë-xarrë (me kalim nga Pllaka)

Linja Shkallë-Sarandë-Shkallë

Linja Shalës-Sarandë-Shalës

Linja Ninat-Sarandë-Ninat (me kalim nga Butrinti)

Linja Shëndëlli-Sarandë-Shëndëlli

Linja Markat-Sarandë-Markat

Bashkia Himarë:

Linja Kuç-Vlorë-Kuç

Linja Vranisht-Vlorë-Vranisht

Linja Tërbaç-Vlorë-Tërbaç

Linja Bolenë-Vlorë-Bolenë

Linja Borsh-sarandë-Borsh

Linja Sarandë-Lukovë-Sarandë

VKM 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”.

Zbatimi i VKM 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për

regjistrimin e tyre” i ndryshuar është ndjekur nga specialistët përkatës, të cilët kanë shqyrtuar dosjet e paraqitura nga bashkitë respektive dhe kanë përgatitur materialin për miratim në mbledhjet e Këshillit të Qarkut. Totali i dosjeve të hyra në institucionin e Këshillit të Qarkut Vlorë janë shuma e dosjeve të kaluara me vendim dhe atyre të kthyera për plotësim me dokumentacion sipas VKM 608.

Për bashkitë Selenicë, Konispol dhe Finiq nuk ka dosje të ardhura për shqyrtim .

Janar – shtator 2018

BASHKIA						
Vlorë	Sarandë	Himarë	Selenicë	Delvinë	Konispol	Finiq
MEVENDIM						
15	4	5	-	13	-	-
TË KTHYERA						
11	-	5	-	1	-	-

VKM 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Sa i takon zbatimin të VKM 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” janë shqyrtuar të gjitha rastet e paraqitura te Këshilli i Qarkut Vlorë. Të gjitha rastet janë inspektuar në vend, janë bërë matjet faktike dhe janë hartuar preventivat përkatës. Rastet që janë kthyer pa preventivin përkatës pranë bashkive respektive kanë qenë për arsye të mungesës së dokumentacionit të përcjellë pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, të tejkalimit të afateve të parashikuara në VKM nr 329, datë 16.05.2012 si dhe mungesës së gjurmëve të ndodhjes së fatkeqësisë në momentin e inspektimit nga komisioni i vlerësimit të Këshillit të Qarkut Vlorë.

Janar – shtator 2018

BASHKIA				
Vlorë	Himarë	Selenicë	Sarandë	Konispol
ME PREVENTIV				
117	1	84	3	1
TË KTHYERA				
-	-	9	3	1

- Rastet në bashkinë Vlorë kanë qenë: 5 raste të klasifikuara për fatkeqësi natyrore rënie zjarri dhe 111 raste për fatkeqësi natyrore përmytjet e fundvitit 2017.
- Rastet për bashkinë Selenicë kanë qenë: 5 raste të klasifikuara për fatkeqësi natyrore rënie zjarri dhe 85 raste fatkeqësi natyrore tërmeti i muajit maj 2018.

Ndihma dhe shërbimet shoqërore

Në mbështetje të ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 839, datë 03.12.2014 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 425, datë 27.06.2012, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror“, si dhe udhëzimit nr. 2470, datë 06.12.2006 “Mbi zbatimin e VKM Nr, 209“ pika I: “Vendosja e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar, të moshuarve në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror bëhet nga komisionet e vlerësimit të nevojave të personave, që ngrihen dhe funksionojnë në nivel bashkie, qarku dhe në Shërbimin Social Shtetëror” si dhe bazuar në kërkesat dhe dosjet që paraqiten nga bashkitë e qarkut për sistemimin e fëmijëve në institucione rezidenciale, gjatë vitit 2018 janë shqyrtuar dhe janë sistemuar tre raste të Shtëpia e Fëmijës, Vlorë dhe janë transferuar pesë raste në shtëpinë e fëmijës “Vangjel Pulla” Sarandë.

Procedura që ndiqet në raste të tilla është shqyrtimi i dosjeve dhe materialeve që përcillen nga njësi vendore që bën kërkesën dhe miratimi në mbledhjen e këshillit për zgjidhjen e rasteve specifike. Kriteret e shqyrtimit lidhen me vlerë-

simet socio-ekonomike të familjareve të fëmijëve, dhe me mundësitë më të mira për fëmijën, bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, duke konsideruar së pari interesin më të lartë në të mirë të fëmijës.

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (DAMT)

DAMT-ja e Qarkut Vlorë funksionon në zbatim të ligjit 10257, datë 25.03.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001”, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.

Në zbatim të këtij ligji kryhen korrespondencat midis institucioneve dhe personave fizikë dhe juridikë, të cilëve u vihen në dispozicion dokumentacioni arkivor teknik për rrethet Vlorë, Sarandë, Delvinë. Gjatë periudhës 10 mujore të vitit 2018 janë kryer rreth 3500 korrespondenca.

Me rëndësi të veçantë për vitin 2018 është mbyllja e reformës territoriale, ku DAMT -ja raporton çdo javë mbi ecurinë e saj në Ministrinë e Bujqësisë dhe në Kryeministri.

Gjatë këtij viti në zbatim të VKM-së nr.410 datë 27.06.2012 janë bërë mbledhje në Bashkinë Konispol për ndryshimin e zërit kadastral për tokën bujqësore, një procedurë e re që nuk është kryer më parë.

Në zbatim të VKM-së nr.337 të vitit 2015 janë kryer korrespondencat me bashkitë që mbulon territori i Qarkut Vlorë për kalimin e tokës bujqësore, nga përdorimi në pronësi, duke kontrolluar gjendjen kadastrale të parcelave .

Në zbatim të Ligjit NR.9948 ,datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, DAMT-ja ka vënë në dispozicion materialet teknike dhe shprehjen e parcelave mbi to, korrespondencë që është kryer në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Vlorë.

Në vitin 2018 është mbledhur Komisioni i Mbrojtjes së Tokës ,(K.M.T) i drejtuar nga kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i këtij komisioni parashikohen nga ligji nr. 9244 i vitit 2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”. Të pranishëm në mbledhje kanë qenë anëtarët e KMT –së sipas VKQL Prefekti i Qarkut Vlorë, Drejtori i Policisë së Qarkut Vlorë, kryetarët e bashkive Himarë, Delvinë, Finiq, Konispol, Drejtori i Bordit të Kullimit, Drejtori i Baseneve, Drejtoresha e QTTB-së, stafi i DAMT së Qarkut Vlorë dhe të ZAMT Delvinë e ZAMT Sarandë, Shërbimi pyjor i bashkisë Finiq, përfaqësues nga Drejtorja e Rajonale e Bujqësisë,Vlorë dhe Drejtorja e ARM-së.

Nga kjo mbledhje Komisioni i Mbrojtjes së tokës vendosi:



1. Të ngrihet grup pune sipas bashkive me specialistë nga: Drejtoria Juridike, Drejtoria e Taksave, Z.M.M.T.-ve të saj dhe Kryetari i fshatit për të kryer një evidentim të saktë për territorin që mbulojnë në lidhje me:


- a) Për kanalet kullues dhe në gjendje pune dhe sa është jashtë funksionimit.
- b) Të raportojë fondit vjetor të 40% të taksës së tokës bujqësoree cilaplani-fikohet në buxhet.

2. Të kërkohet nga Drejtoria Rajonale e Ujërave (Bordi i Kullimit), se si është ndarja e fondit financiar në bashkitë e qarkut Vlorë (Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Delvinë, Finiq).

Sistemi në kohë reale për shërbimin ndaj qytetarëve

Në vitin 2017, me mbështetje të bankës Societe General, dega Vlorë u realizua një projekt për të përmirësuar shërbimin ndaj qytetarëve dhe për të dhënë transparencë për shërbimet që institucioni u ofron drejtpërdrejt qytetarëve. Ky projekt konsistoi në aktivizimin e një sistemi online, ku qytetarët kanë mundësi të njihen me shërbimin ndaj kërkesës së tyre drejtuar institucionit. Në këtë mënyrë, çdo qytetar ka të drejtë të gjurmtojë përgjigjen e kërkesës së vet dhe të ketë shërbimin në kohë dhe me transparencë, përtej çdo procedure rutinë dhe me zvarritje kohore.

Kështu, për vitin 2018 paraqitet një grafik mbi aksesin dhe ofrimin e shërbimit për qytetarët përmes këtij sistemi inovativ për shërbimin.



Gjatë periudhës së funksionimit të programit janë përpunuar kërkesat si me poshtë:

- Vërtetime me të dhëna nga formulari nr. 6 392 vërtetime
- Vërtetim pronësie pas vitit 1946 130 vërtetime
- Vërtetim pronësie para vitit 1946 14 vërtetime
- Vërtetim për kategorizimin e tokës sipas bonitetit 9 vërtetime
- Harta dhe skica planimetrike-kadastrale 6 vërtetime
- Konfirmim Projekti-Leje ndërtimi miratuar nga KRRT 5 vërtetime
- Vërtetim negativ para reformës, për në gjykatë 5 vërtetime
- Të tjera 368 dokumente

Kanë marrë shërbim 963 qytetarë .

Për të patur mundësi përdorimi si qytetar në këtë sistem duhet të:

Hapi 1: Futësh në faqen elektronike www.qarkuvlore.gov.al te kolona Qytetari


Hapi 2: Futësh kodin e shkreses

Hapi 3: Shohësh informacionin ne lidhje me shkresen: perfunduar, në proces


Mund të përdoret ky sistem nga çdo kompjuter, celular android apo smart.

Shoqëria “Bajkaj Land” Sh.a

Shoqëria “Bajkaj Land” Sh.a është krijuar nga Këshilli i Qarkut Vlorë, në funksion të menaxhimit dhe vënies në funksionim të Landfillit të ndërtuar në fshatin Bajkaj dhe të Stacionit të Transferimit në Himarë, të ndërtuar në kuadër të projektit “Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i Zonës Bregdetare” të financuar nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare dhe donatorë të tjerë. Aktiviteti ekonomik për vënien në punë të landfillit Bajkaj nisi në muajin Shtator 2015 dhe sot kjo infrastrukturë është në shërbim të pesë njësive vendore, të bashkive Sarandë, Delvinë, Himarë, Finiq, Konispol si dhe enteve të tjera publike dhe private. Është objekti i parë infrastrukturor mjedisor i ndërtuar në jug të vendit për menaxhimin e mbetjeve, që ka siguruar një grumbullim të sigurtë të mbetjeve urbane dhe përmirësim të dukshëm të kushteve mjedisore, që erdhi si rrjedhojë e mbylljes perfundimtare të vendeve ekzistuese të hedhjes së mbetjeve urbane jo të rrezikshme.



LAJME



Mjetet qe operojne ne landfillin Bajkaj

EMËRTIMI	VLEFTA (lekë)
Kompaktor	43,888,000
Buldozer	42,548,600
Eskavator	30,445,232
Kamion vetëshkarkues	11,187,000
Autoveturë	179,454
Totali	128,248,286



Pavarësisht vështirësive qe ka çdo fillim aktiviteti prodhues e menaxhues, aq me tepër ngritja e një strukturë që nuk ka ekzistuar më parë, siç është kjo e landfillit në Bajkaj dhe Stacionit të Transferimit në Himarë, me experiencë të pakët në menaxhimin e mbetjeve urbane dhe me vështirësi financiare, jo vetëm për këtë shoqëri të re, por edhe për vetë njësitë vendore bashkiake, të cilat erdhën nga një strukturim rrënjësor i pushtetit vendor përmes reformës territoriale, falë përkushtimit të stafit prej 17 punonjësish, ndihmës së Këshillit të Qarkut Vlorë, mireëkuptimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me njësitë e qeverisjes vendore, sot shoqëria “Bajkaj land” Sh.a ka krijuar profilin e saj si një shoqëri aksionere që pasuron eksperiencen në fushën e mbetjeve, duke treguar hap pas hapi se është në gjendje të menaxhojë dhe operojë landfillin, si në aspektin teknik, ashtu edhe atë financiar, me objektiv mbrojtjen e mjedisit.

Depozitimi i mbetjeve në ton në vitin 2018	
Emërtimi	2018 Janar-Tetor
Bashkia Sarandë	8,637.31
Bashkia Delvinë	782.73
Bashkia Himarë	3,268.20
Bashkia Finiq	403.36
Bashkia Konispol	495.31
“Finikas” sh.p.k Sarandë	8.72
Totali	13,596
Sasia mesatare /muaj	1360
Sasia mes/dit	44.72

Landfilli ka sipërfaqe 58150 m² dhe kapacitet 820000 m³ dhe është ndarë në dy qeliza, nga të cilat, qeliza e parë, që është në funksionim, ka sipërfaqe prej 30500 m², me kapacitet prej 365,000 m³, ndërsa qeliza e dytë ka sipërfaqe prej 27650 m² dhe kapacitet 455000 m³ dhe që vetëm sa është modeluar). Jetëgjatësia e funksionimit të landfillit, përfshirë të dy qelizat është rreth 17 vjet. Në funksion të volumit total të mbetjeve të ngurta urbane dhe viteve të shfrytëzimit, kapaciteti pritës dhe përpunues ditor i mbetjeve është llogaritur të jetë 80-100 ton/ditë. Aktualisht, në landfill hyjnë 37 ton mbetje në ditë.

Stacioni i Transferimit në Himarë, që është infrastrukturë ndihmëse e landfillit, e ndërtuar në Vumblo, fshati Pilur, ka sipërfaqe rreth 2.000 m² dhe kapacitet trajtimi prej 30 t/ditë. Është duke u kompletuar edhe me mjetet e transportit të mbetjeve për në landfill dhe do të jetë funksional brenda vitit 2019. Kjo do t'i vijë në ndihmë bashkisë Himarë, duke ndikuar në përmirësimin e pastrimit të territorit të saj dhe uljen e kostos.

Landfilli në fshatin Bajkaj është konceptuar që të mundësojë zgjerim të sipërfaqes së venddepozitimit me 65.400 m² dhe të mbërrijë në një volum total prej 1.720.000 m³ dhe jetëgjatësi deri 27 vjet.

Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit si 10-mujor të 2018

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr.68 dt.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar; ligjit nr 11/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, neni 16; udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018.“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 dt 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” është realizuar monitorimi dhe zbatimi i buxhetit për 10-mujorin e vitit 2018.

Buxheti i Këshillit të Qarkut Vlorë për 10 mujorin e vitit 2018 është produkt i zbatimit të politikave të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut, në sistemin fiskal dhe atë të menaxhimit të shpenzimeve, për të ofruar shërbime në standarte sa më të larta. Ky dokument paraqet detajet e punës së administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë, si dhe arritjet e saj gjatë kësaj periudhe, duke u përqendruar kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet, në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më mirë të shpenzimeve, si pjesë e rëndësishme e objektivave të ndërmarra gjatë kësaj periudhe.

Burimet e financimit:

- Të Ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

Funksionet kryesore të strukturave financiare :

- a. Për funksionet e veta
- b. Për funksionet e përbashkëta
- c. Për funksionet e deleguara

Vështrim i përgjithshëm mbi realizimin e buxhetit si 10-mujor i vitit 2018

Të ardhurat e Këshillit të Qarkut Vlorë


Në të ardhurat e Këshillit të Qarkut të Vlorës përfshihen të ardhurat e veta nga tarifat vendore si dhe të ardhurat nga buxheti i shtetit, fondet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara.

Të ardhurat nga tarifat vendore

Gjatë 10-mujorit të vitit 2018, në sistemin fiskal realizimi i të ardhurave në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka një rritje në total prej 2.655.145. lekë, ose në % rritje 128%. Realizimi i të ardhurave si 10 mujor, të ndara sipas natyrës të të ardhurave rezulton:

- Derdhja e kuotës së antarsisë, vlen të theksohet se kemi një rritje duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Realizuar si 10-mujor viti **2017** në vlerë **7.451.421**, realizuar si 10-mujori viti **2018**, në vlerë **11.314.083** rritje në vlerë prej **2.655.145** lekë, ku disa bashki kanë derdhur dhe për detyrimet që kanë për vitin e kaluar.
- Të ardhurat dytësore nga shërbimet që ofron Këshilli i qarkut kemi një rënie në krahasim me të njëjtën periudhë me vitin e kaluar në vlerë prej 323.413 lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i uljes së aplikantëve për formular nr. 6 të pajisjes me tokë bujqësore.

Grafiku paraqet realizimin e të ardhurave të arkëtuara gjatë 10 mujorit 2018.



Të ardhurat nga buxheti i shtetit

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjitha transfertat nga buxheti i shtetit për përbalimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara dhe një pjesë të funksioneve të veta dhe të përbashkëta.

Të ardhurat nga fondet e pakushtëzuara (Granti)

Gjatë 10-mujorit 2018, shuma totale e grantit prej 42.828.875 lekësh, përbëhet nga:

Granti i përfituar nga pushteti qendror gjatë 10-mujorit 2018 **31.666.616 lekë.**

Grant i trashëguar nga shpenzimet e vitit 2017 **21.546.116 lekë.**

Transferta e Pakushtëzuar (granti) është e ardhur e Pushtetit Vendor, e trashëgueshme, e përfituar nga Buxheti i Shtetit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e përcaktuara si më poshtë:

- Pagat e personelit,
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.
- Për shpenzime operative
- Investime
- Bashkëfinancim për projektet e BE-së
- Investime (bashki)

Të ardhurat nga fondet e kushtëzuara

Gjatë 10 mujorit të vitit 2018, Këshilli i Qarkut Vlorë për përmbushjen e funksioneve të deleguara dhe të përbashkëta, ka përfituar nga buxheti i shtetit fonde të kushtëzuara, buxhetore për shpenzime në shumën prej **13.539.000** lekë, (**5.703.000** lekë (DAMT + 7.836.000 lekë Qendra Psiko Sociale Vatra). Ky akordim është kryer në mbështetje të programit fillestar të buxhetit dhe parashikon mbulimin vetëm të shpenzimeve për funksionet e deleguara dhe të përbashkëta (DAMT, Qendra Psikosociale Vatra).

Shpenzimet e përgjithshme gjatë 10-mujorit të vitit 2018, për qarkun janë realizuar në shumën prej **45.846.542** lekë ose e shprehur në përqindje **61%**, ndaj programimit 10 mujor **76.272.909** lekë.


Shpenzimet korrente

Shpenzimet korrente për qarkun e Vlorës gjatë 10-mujorit të vitit 2018, janë realizuar në shumën prej **37.153.113** lekë ose **88 %** ndaj planit të programuar prej **42.332.209** lekë, kurse shpenzimet kapitale për këtë 10-mujor janë re-

alizuar në shumën prej **8.693.429** lekë, ose **25.6%** ndaj planit të programuar **33.940.700** lekë.

Realizimi i shpenzimeve të qarkut Vlorë për 10 mujorin e vitit 2018.

Shpenzimet Totale si 10 mujor viti 2018



Analiza analitike e shpenzimeve për 10-mujorin e vitit 2018 (Administrata)

Ky buxhet i administratës paraqitet përgjithësisht i realizuar në disa nga zërat e shpenzimeve, duke ruajtur një raport të drejtë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke reflektuar një bilanc pozitiv të pagesave, brenda limiteve të miratuara nga Këshilli i Qarkut.

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas strukturave, përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administrata e Këshillit të qarkut gjatë 10 mujorit viti 2018 rezulton si më poshtë:


Gjatë 10-mujorit të vitit 2018, në total shpenzimet e përgjithshme të administratës janë realizuar në shumën prej **24.787.445** lekë, ndaj programimit vjetor prej **47.521.875** lekë ose e shprehur në përqindje në **52%**.

Si shpenzime korrente për administratën në Qarkun e Vlorës gjatë 10-mujorit të vitit 2018, janë realizuar në shumën prej **19.094.016 lekë** ose **86%** ndaj planit të programuar prej **22.321.875 lekë**, kurse shpenzimet kapitale për këtë

10 mujor janë realizuar në shumën prej **5.693.429 lekë ose 22.5%** ndaj planit të programuar prej **25.200.000 lekë**.

Ecuria e shpenzimeve korrente ka qenë në përpjestim të drejtë për të gjithë muajt, kurse ecuria e shpenzimeve kapitale ka qenë jo e kënaqshme, pasi janë përdorur vetëm 22.5% e fondeve të programuara. Grafiki, realizimi i fondeve sipas artikujve për 10/ mujorin viti 2018, vetëm për treguesit e administratës së qarkut Vlorë janë paraqitur më poshtë:

**Shpenzimet e Administratës së Këshillit të Qarkut si
10 mujor i vitit 2018**



Shpenzimet kapitale për këtë 10 mujor janë realizuar në shumën prej **8.693.429 lekë ose 26%** ndaj planit të programuar prej **33.940.000 lekë**.

Tabloja e realizimit të investimeve Plan-Fakt në mijë/lekë

Investimet si 10-mujor	33.940	8.693
Ndërhyrje rikualifikuse në Çezmën Drashovicë, B. Selenicë	2.500	1.693
Ndërtim i kullave të vrojtimit në Lagunën e Nartës	3.000	-
Sistemim i zonës fushë sporti Novoselë b. Vlorë	5.000	-
Ndërhyrje rikualifikuse në sheshin Qendër		
Bolenë, Horë – Vranisht B, Himare.	3.000	-
Pajisje dhe mobilim Zyrrat e K. Qarkut	2.700	
Bashkëfinacim në segmentin rrugor Vagalat –		
Karroq Pika Kufitare Rips – Ampelona b. Finiq.	3.000	3.000
Rikonstruksion rruga e shkollës Konispol - b. Konispol	4.000	4.000
Bashkëfinacim për projektet e BE-së	10.740	-

Diferenca në këtë grup artikujsh vjen si pasojë e mos realizimit të Investimeve të parashikuar për:

- Ndërtimin e dy kullave të vrojtimit në Lagunën e Nartës, (tenderuar) .
- Ndërhyrje Rikualifikuse në Çezmën Drashovicë B. Selenicë është realizuar në 67.7 % (tender) sipas vlerës së fituar dhe kontratës së lidhur.
- Sistemim i zonës së fushës të Sportit Nja Novosele B.Vlore (në proces tenderimi).
- Ndërhyrje rikualifikuse në sheshin Qëndër Bolene Nja. Hor – Vranisht B, Himare (Nn proces).
- Pajisje dhe mobilim Zyrrat e K. Qarkut (Nuk janë realizuar pasi janë parashikuar për te zyrrat që është diskutuar per transferim).
- Bashkefinacim Projekte te BE (Eshte filluar me vonese zbatimi i projekteve dhe parashikimet e ketij viti spostohen per vitin 2019 e ne vijim)

Informacion njohës për Qarkun Vlorë

Qarku i Vlorës është një prej 12 qarqeve në Shqipëri e themeluar si njësi e qeverisjes vendore në nëntor të vitit 2000. Qarku Vlorë përfshin në territorin e vet 7 bashki: Vlorë, Himarë, Sarandë, Delvinë, Finiq, Konispol dhe Selenicë. Kryeqyteti rajonal është Vlora. Popullsia është 380.184 banorë rezidentë dhe banorë në një sipërfaqe prej 2706 km². Ndodhet në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë dhe laget nga deti Adriatik dhe deti Jon.

Sipërfaqja totale:	2706 km²
Popullsia:	189.282
Kufiri tokësor:	54 km
Gjatësia bregdetare:	244 km
Kufijtë kombëtarë	Qarku Fier në veri, Qarku Gjirokastrë në jug



Qarku	Bashkia	Njesia administrative
Vlorë	Vlorë	Orikum Qendër Shushicë Novoselë
Vlorë	Himarë	Himarë Horë-Vranisht Lukovë
Vlorë	Selenicë	Armen Vllahinë Kotë Brataj Sevaster
Vlorë	Sarandë	Sarandë Ksamil
Vlorë	Konispol	Konispol Xarë Markat
Vlorë	Finiq	Livadhja Dhiver Aliko Mesopotam Finiq
Vlorë	Delvine	Delvine Vergo

KONTAKT

Këshilli i Qarkut Vlorë

Sheshi “4 Heronjtë” 9401

Vlorë Shqipëri

Tel: +355 33 421 600 Fax: +355 33 421 601

E-mail: info@qarkuvlore.gov.al

web: www.qarkuvlore.gov.al

